



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 643/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Xhevdet Abazi kryesues, Muharrem Shala, dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Sylejman Meholli, kandidat për anëtarë të kuvendit komunalë në Vushtrri nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur për shkak të mungesës së votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 08.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e palejueshme ankesa e Sylejman Meholli, kandidat për anëtarë të kuvendit komunalë në Vushtrri nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV)

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 05.11.2013, nga Sylejman Meholli, kandidat për anëtarë të kuvendit komunalë në Vushtrri nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendohet se në fshatin Shtitoricë komuna e Vushtrrisë me datën 03.11.2013 nga ora 19 - 23 ka pasur parregullsi si në numërimin e votave brenda subjekteve ashtu edhe në mes të subjekteve duke bërë tjetërsimin e votave dhe bartjes së votës së një kandidati të një kandidat tjetër, ku edhe personit në fjale ju janë tjetërsuar votat e tij.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultatit preliminarë i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment dhe po ashtu ankesa në fjalë për rezultat preliminar në vendvotim është dashtë të parashtrohet në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së parasheh se “Çdo anëtarë i komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje te Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në përputhje me këtë ligj”. Në rastin konkret ankesa është parashtruar nga kandidati për anëtarë të

kuvendit komunal që nuk është person i autorizuar sipas ligjit të parashtrori ankesë sipas dispozitës së lartcekur.

Bazuar në arsyet e sipërshtënuar dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 643/2013 më datën 08.11.2013



**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**

Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.